

STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“FUGAZI” Sh.p.k.

Mbi bazën e kërkesave te ligjit Nr. 9901 te datës 14.04.2008 “Për shoqëritet tregtare” dhe te ligjit Nr. 9723 te datës 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit” krijohet shoqëria tregtare “FUGAZI” sh.p.k., e cila do te veproje ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

KAPITULLI 1
EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRITARISE, SELIA , KOHEZGJATJA

NENI 1
EMERTIMI I SHOQERISE DHE THEMELUESIT

Krijohet shoqëria tregtare e emërtuar “FUGAZI” sh.p.k., me ortake:

1. Ortaku Z.Amir Sinani , lindur ne ,Tirane, Shqiperi, me 09.01.1993, i identifikuar me Pashaporte me Nr Personal. J30109056F ;

NENI 2
SELIA

Shoqëria e ka selinë e saj ne adresën: Rruga Abdi Toptani, Tore Drini, Kati i 6-te, Ap.64 , Njesia Bashkiake Nr.9 , Tirane , Shqiperi .

Shoqëria mund te çele, seli te tjera te dyta, dege, përfaqësimi apo agjenci operative ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë dhe jashtë saj, ne përputhje me ligjin ne fuqi.

NENI 3
KOHEZGJATJA

Shoqëria do te ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë se saj me një afat kohor te pacaktuar.

NENI 4
VULA

Shoqëria do te ketë vulën e saj.

NENI 5
OBJEKTI

Shoqëria do te ketë Statutin e njëshoqërie me përgjegjësi te kufizuar dhe do te përballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesve te saj ne kapitalin fillestar.

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë do te jetë:

Sherbime ne fushen e biznesit , sherbime marketing online , sherbime juridike .



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Z. Amir Sinani". There is a small number "1" at the end of the signature.

KAPITULLI II **KAPITALI**

NENI 6 **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali fillestare i shoqërisë është i barabartë me 10000 (dhjetemije) leke , i cili miratohet nga ortaket, dhe nuk eshte i derdhur nga ortaket themelues dhe ndahet ne 1 (nje) kuote me vlore te barabartë me 10000 (dhjetemije) leke, qe përben 100 % (nje qind per qind) te kapitalit te shoqërisë;

Kapitali është i ndare mes ortakeve themelues si me poshtë:

- 1) Ortaku Z. Armir Sinani mbajtës i 1 (një) kuote me vlore nominale te barabartë me 10000 (dhjetemije) leke qe përben 100% (njeqind per qind) te kapitalit te shoqërisë;

NENI 7 **PJESEMARRJET NE KAPITALIN THEMELTAR**

Pjesëmarrjet e ortakeve ne kapitalin themeltar përcaktohet ne raport te drejte me kontributet e tyre ne kapitalin themeltar.

Te drejtat, përfshirë edhe te drejtat e votës, u takojnë ortakeve ne mënyrë përpjesëtimore me pjesëmarrjen qe zoteron secili ne kapitalin themeltar.

Ne rast tjetërsimi te pjesëmarrjes ne kapitalin themeltar, ortaket e tjerë gjëzojnë te drejtën e parablerjes. Me "tjetërsim" nënkuftojmë çdo akt tjetërsimi i kuotave, ne kuptimin me te gjere te fjalës, si ne pronësi te plote ashtu dhe te pjesshme, qe, ne mënyre direkte apo indirekte, sjell ndryshimin e titullit te pronësisë mbi kuotat ose te drejtat mbi to.

Ortaku qe synon te tjetërsojë, tërësish ose pjesërisht, kuotat e tij ne kapitalin themeltar duhet t'i komunikojë ortakeve te tjerë ne asamble ose nëpërmjet letre rekomande, ofertë e marre, duke treguar emrin e blerësit te mundshëm dhe kushtet e tjetërsimit, ne mënyrë te veçante çmimin e përcaktuar dhe mënyrat e pagesës (këtu e me poshtë oferta).

Brenda njëzet ditëve nga marrja e komunikimit te Ofertës, ortaket e interesuar ne ushtrimin e se drejtës se parablerjes duhet t'i komunikojnë ortakut qe kalon te drejtat mbi kuotat, dëshirën për te ushtruar te drejtën e parablerjes, përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e secilit ne kapitalin themeltar dhe sipas kushteve te Ofertës, duke shprehur edhe interesin e mundshëm për blerjen e pjesës se kuotave për te cilën nuk është ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakeve te tjerë. Është i pavlefshëm çdo komunikim qe nuk përban te gjithë te dhënat e mësipërme.

Ne rast se ndonjë nga personat qe gjëzon te drejtën e parablerjes se kuotave, nuk mund ose nuk dëshiron ta ushtroje atë, e drejta e parablerjes qe i takon zmadhohet automatikisht dhe përpjesëtimisht ne favor te ortakëve qe kane shprehur interesin për ta ushtruar këtë te drejte.

Ne rast se janë disa ortake qe ushtrojnë te drejtën e parablerjes, kuotat do te shpërndehen ndërmjet tyre ne përpjesëtim me pjesëmarrjen e secilit ne kapitalin themeltar te shoqërisë. Ne rast se ne letrën e komunikimit te Ofertës tregohet si blerës i mundeshme një person qe është ortak, edhe atij i njihet e drejta e parablerjes, krahas ortakeve te tjerë.

E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet për te gjithë pjesëmarrjen e ofruar dhe për çmimin e përcaktuar, duke qene se i tille është objekti i propozimit te paraqitur nga ortaku ofrues.

Ne rastin e ushtrimit te se drejtës se parablerjes, nënshkrimi i kontratës se shitjes se kuotave dhe pagesa përkatëse duhet te kryhen brenda afateve te përcaktuara ne propozimin e shitjes se formuluar nga ortaku ofrues.

Nëse e drejta e parablerjes nuk ushtrohet brenda afateve te mësipërme dhe për tërësinë e pjesëmarrjes se ofruar, ortaku ofrues mund t'i transferoje kuotat e veta ne favor te blerësit te treguar ne

komunikimin e Ofertës dhe ne kushtet e parashikuara ne te, brenda gjashtëdhjetë ditëve te ardhshme. Ne te kundërt procedura e parablerjes duhet te përsëritet.

Ne rast tjetërsimi te kuotave ne favor te te trentëve, pa zbatuar dispozitat e parashikuara me sipër, blerësi nuk do te legjitimohet ne ushtrimin e te drejtave administrative dhe pasurore dhe tjetërsimi i kuotave nga ana e tij nuk do te prodhoje efekte ndaj shoqërisë.

Nëse asnjeri prej ortakeve nuk e ushtron te drejtën e parablerjes ne mënyrat e përcaktuara, ortaku ofrues mund te nënshkruajë aktin e shitjes se pjesës se tij ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. E drejta e parablerjes nuk është domosdoshmërisht e nevojshme te ushtrohet prej ortakeve, ne rast transferimi tek familjarët, te kuotave ose te pjesëve te kuotave te zotëruara prej tyre.

NENI 8 **ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqërisë mund te shtohet ose te pakësohet me vendim te Asamblesë se Ortakeve, por asnjëherë nuk mund te zvogëlohet nen nivelin e kapitalit fillestare derdhur.

NENI 9 **TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit te njëshoqërie me përgjegjësi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. Kontributit fillestare;
- b. Shitblerjes;
- c. Trashëgimisë;
- d. Dhurimit;
- e. Çdo mënyretjetër te parashikuar ne ligj.

Ortaket mund te shesin pjesërisht apo tërësisht kuotat e tyre te kapitalit. Shitia e kuotave tek te tretet behet vetëm pasi te ketë marre vendim Asambleja e Ortakeve dhe nëpërmjetkontratës se shitjes se kuotave te kapitalit.

KAPITULLI II **ORAGENET DREJTUESE**

NENI 10 **ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese te shoqërisëjanë:


- Asambleja e Ortakeve;
- Administratori.

NENI 11 **ORGANI VENDIMARRES**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëmvendimmarrës i shoqërisë, ortaket vendosin mbi çështjet qe i rezervohen nga ligji ose nga ky Statut, si dhe mbi çështjet qe njeri ose disa prej administratoreve i paraqesin për miratim.

Ortaket gjëojnë te drejtën te thërrasinësamblenë e ortakeve ne rastet dhe me shumicat e përcaktuara ne ligj.

Janë ne çdo rast ne kompetence te Asamblesë qe vendos me mazhorance te thjeshte te votave te ortakeve pjesëmarrës kur janë prezent me shume se 30 % e kuotave te kapitalit themeltar, përvendimet qe kërkojnë shumice te zakonshme, si me poshtë:



A handwritten signature in blue ink, appearing to be a name, is placed here.

1. Emërtimin e shkarkimin e administratorit;
2. Emërtimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar, duke përcaktuar ne ketë rast kriteret e likuidimit;
3. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur ne pikën 1 dhe 2;
4. Çështje te tjera te parashikuara nga ligji apo Statuti.

Janë ne kompetencën e Asamblesë se Ortakeve e cila vendos me votën ne favor te $\frac{3}{4}$ te ortakeve prezent qe përfaqësojnë me shume se gjysmën e kapitalit te shoqërisë, vendimet qe kane lidhje me :

1. Miratimin e bilancit dhe shpërndarjen e fitimeve;
2. Ndryshimet e këtij statutit;
3. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar;
4. Ndryshimin e formës se shoqërisë apo riorganizimin e saj;
5. Shpërndarjen e shoqërisë.

Asambleja mund te mblidhet ne mënyrën te jashtëzakonshëm kur e kërkojnë administratori apo me shume se një e treta e ortakeve te shoqërisë. Ne mbeshtetje te nenit 88 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ortaket kane te drejtësper te marre unanimisht cdo vendim, me kusht qe kjo marreveshje te behet me shkrim.

NENI 12 MBLEDHJA E ASAMBLESE

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga ky Statut dhe në rastet e përcaktuara nga ligji nr. 9901, i 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligje të tjera, dhe çdo herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqëri. Takimi i rregullt i Asamblesë së Përgjithshme është bërë të paktën një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori ose nga ortaket në përputhje me nenin 12 të këtij statutit.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në qoftë se, nga pasqyrat financiare vjetore apo prospektet e rezultateve të ndërmjetme, ekziston rreziku që fitimet e kompanive nuk i mbulojnë detyrimet e duhura për 3 muajt e ardhshëm.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet kur shoqëria, brenda dy viteve të para të krijimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, asetet me një vlerë mbi 5% të aseteve të shoqërisë që rezulton nga deklaratat e fundit financiare e certifikuar.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, duhet t'i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme një raport i detajuar nga një kontabilist i autorizuar me licencë i pavarur.

Nëse asambleja nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit, mbledhja thirret përsëri brenda 30 ditëve me të njëjtin rend dite.

NENI 13 THIRRJA E ASAMBLESE

Asambleja e ortakeve e thirrur rregullisht përfaqëson bashkësinë e ortakeve dhe vendimet e saj te marra ne përputhje me ligjin dhe këtë statut janë te detyrueshme për të gjithë ortaket edhe në sekëtamungojnë ose nuk janë te tenjëtit mendim.

Asambleja e Ortakeve thirret me një njoftim me shkrimdërguar ortakeve ne vendbanimin e tyre ose ne adresën e postes se tyre elektronike.

Njoftimi me shkrim ose me e-mail, duhet të tregojë vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'i komunikohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 ditë para datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.

Njoftimi për thirrjen e asamblesë është bërë me shkrim dhe do të dorëzohet për secilin ortak në adresën e regjistruar në regjistrin e ortakeve të paktën 7 (shtatë) ditë para mbledhjes.

Përveç sa me sipër, njoftimi për thirrjen e asamblesë mund të bëhet nëpërmjet dorëzimin e tij administratorit, ky i fundit ka përgjegjësinë e dorëzimit te këtij njoftimi, ortakeve.

Në numërimin e shtatë ditësh nuk merret parasysh, dita e dorëzimit të njoftimit dhe dita e mbajtjes se mbledhjes.

Kur asambleja nuk është mblidhet në mënyrën e përshkruar më lart, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në qoftë se është përfaqësuar tërësia e kapitalit themeltar dhe asnjë nga anëtarët nuk kundërshtojnë diskutimin e çështjeve ne rend te ditës.

Asambleja drejtohet nga administratori. Drejtuesi i Asamblesë konstaton mbledhjen e rregullt te saj, verifikon identitetin dhe legjitimitin e te pranishmeve, drejton dhe garanton zhvillimin e rregullt te saj te asamblesë si dhe verifikon dhe shpall rezultatet e votimeve.

Mbledhja e Asamblesë se ortakeve mund te mbahet edhe nëpërmjet video- konferencës ose telekonferencës, me kusht qe te gjithë përfaqësuesit te mund te identifikohen dhe te dallohen ne çdo moment te lidhjes dhe t'u lejohet te ndjekin diskutimin, te marrin, te dërgojnë dhe te vëzhgojnë dokumentet, te ndërhyjnë gojarisht dhe ne kohe reale mbi te gjitha çështjet, si dhe te marrin pjese ne votim dhe te vendosin, ne mënyrë te tille qe te mund te garantohet metoda kolegjiale dhe zbatimi i parimeve te mirëbesimit dhe barazisë se trajtimit te ortakeve. Ne prani te kushteve te mësipërme, asambleja e ortakeve konsiderohet e mbajtur ne vendin ne te cilin gjendet drejtuesi i saj ose ne vendin qe tregohet ne njoftimin e mbledhjes se saj. Çdo ortak ka te drejtë e pjesëmarrjes dhe te votës ne asamble ne përpjesëtim me pjesëmarrjen qe zoteron ne kapitalin themeltar.

Ortakët mund te përfaqësohen ne asamble nga persona te tjerënepërmjetnjë autorizimi apo prokure te posaçme. Autorizimi apo Prokura është e vlefshme vetëmpërasamblenëpër te cilënlëshohet, te identifikuar sipas rendit te ditës gjithashtu përfshin takime pasuese me të njëjtin rend dite. Ortaket nuk mund te përfaqësohen nga administratori i shoqërisë.

Vota duhet te jete e hapur ose gjithsesi te shprehet me modalitete te tilla qe te bëjnë te mundur identifikimin e ortakeve qe nuk janë ne te njëtin mendim. Modalitetet e votimit miratohen nga Asambleja e ortakeve me shumicën e te pranishmeve, mbi propozimin te administratorit.

NENI 14 AKTET DHE VERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE

Vendimet e Asamblesë se Ortakeve duhet te pasqyrohen ne procesverbalin e mbledhjes. Administratororet janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbalit të mbledhjes së asamblesë.

Procesverbalit duhet të ketë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Presidentit dhe i cili e mban procesverbalin, rezultatet e votimit.

Procesverbalit te Asamblesë i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi për mbajtjen e takimit. Procesverbalit i mbledhjes do të nënshkruhet nga të gjithë ortaket e pranishëm dhe nga ai qe e përpilonatë.

NENI 15 KUNDERSHTIMI I VENDIMEVE TE ASAMBLESE

Administratorët dhe secilido ortak ka të drejtë të ankohet për vendimet e asamblesëpranë Gjykatës së Shkallës së Parë, ku është selia e kompanisë, nëse vendimet janë në kundërshtim me ligjin ose me statutin.

Citati, i përshkruar në paragrafin e mëparshëm, është drejtuar kundër shoqërisë dhe duhet të dorëzohet brenda 3 (tre) muaj nga vendimi.

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'VJG', is positioned at the bottom right of the page. A small number '5' is written next to the signature.

Nëse vendimi është kundërshtuar nga ana e administratorit të shoqërisë, Gjykata e Shkallës së Parë, ku Selia shoqëria, emëron një përfaqësues te shoqërisë në gjykatë.
Gjykimi i pavlefshmërisë ka efekt në lidhje me të gjithë ortaket dhe administratoret.
Për raste qe nuk rregullohen në këtë statut do aplikohet ligji.

NENI 16 ADMINISTRIMI

Asambleja e Ortakeve ka te drejte te vendose nëse administrimi i shoqërisë do te behet nga një administrator i vetëm apo nga Këshilli Administrativ i përberë nga minimumi 3(tre) dhe maksimumi 5 (pese) administratorë.

Administrimi i shoqërisë i cili konsiston ne kryerjen e te gjithë veprimeve te administrimit pë realizimin e objektit te veprimtarisë se shoqërisë, i besohet administratorit te vetëm ose Këshillit Administrativ. Ne rastin e Këshillit Administrativ secili nga administratoret është i detyruar te informoje Këshillin për çdo veprim te kryer dhe ne rast kundërshtish vendos Asambleja e Ortakeve. Administratori i vetëm ose Administratoret (nëse janë emëruar qëndrojnë ne detyre 5(pese) vjet, me te drejte riemërimi, përvèç nëse shkarkohen nga Asambleja e Ortakeve apo rastet e dorëheqjes. Kushdo qe administron shoqërinë përgjigjet personalisht përballë saj dhe te trentëve për shkelje te mundshme te ligjit dhe ose statutit dhe ose gabimet e kryera gjate administrimit te shoqërisë. Ne rast te administrimit me Këshill Administrimi, ky zgjedh brenda tij President dhe një Administrator te Deleguar. Presidenti i Këshillit te Administrimit duhet te thërrasë Këshillin te paktën një here ne dy muaj dhe te njoftoje Këshillin e Administrimit për mbarëvajtjen e shoqërisë. Nëse ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet administratoreve, Presidenti duhet te thërrasë Asamblenë e Ortakeve, e cila mund te vendose ne lidhje me kundërshtitë.

Ne rastin e Këshillit Administrativ, administratoret mund te veprojnë bashke ase veç e veç. Ne çdo rast, nëse ekzistojnë kundërshtime ndërmjet administratoreve këta i drejtohen Asamblesë se ortakeve, e cila dhe mund te zëvendësojë Këshillin e Administrimit e te emëroje administratore te tjerë. Administratori ose Këshilli Administrativ mund te shkarkohen ne çdo moment me vendim te Asamblesë se Ortakeve me votën pro te ortakeve qe përfaqësojnë shumicën e kapitalit te shoqërisë, pa detyrim motivimi. Megjithatë nëse shkarkimi është bere pa arsyte drejtë, administratori mund te kërkojë dëmshpërblim financiar.

Ne rastin e dorëheqjes se një administratori, brenda 30 (tridhjete) ditëve duhet te thirret Asambleja e Ortakëve për emërimin e administratorit te ri, ne rast se ky vendim nuk merret ne te njëjtën mbledhje Asambleje kur është vendosur largimi i administratorit.

Shoqëria e themeluar do te administrohet nga një administrator i vetëm i cili do te qëndrojë ne detyre për një periudhe 5 vjeçare, me te drejte rizgjidhje.

Me themelimin e shoqërisë, emërohet Administrator Z. Armir Sinani , lindur ne ,Tirane, Shqiperi, me 09.01.1993, i identifikuar me Pashaporte me Nr Personal. J30109056F ;,
Emërimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

NENI 17 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka te gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe te jashtëzakonshëm te shoqërisë, me përjashtim te vendimeve qe ligji, statuti, akti i themelimit i rezervojnë Asamblesë se Ortakeve.

Administratori gjzon te drejta te kufizuara ne lidhje me administrimin e llogariserrjedhese te shoqerise, vetem ortaket e shoqerise kane te drejtenpër kryerjen e çdo veprimi dhe /ose operacioni qe evlerësojne te dobishëm për realizimin e objektit te shoqërisë.

Administratori drejton veprimtarinë e shoqërisë dhe ka te drejte qe ta përfaqësoje atë ne marrëdhëniet me te tretet.

Përveç asaj çka parashikohet nga ligji, Administratori ka detyrën e kryerjes se veprimeve te mëposhtme:

1. përgatit dhe harton inventarin, te llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin, raportin e ecurisë se veprimtarisë se shoqërisë, ne mbyllje te çdo viti financiar dhe se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ja dërgon Asamblesë se Ortakeve për miratim;
2. hartimin e projekteve te bashkimit ose te ndarjes se shoqërisë;
3. te informoje asamblenë mbi zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e operacioneve tregtare me rendësi për shoqërinë;
4. te raportojë përparrë Asamblesë se Ortakeve mbi faktet qe mund te kenë pasoja negative mbi ecurinë apo ekzistencën e shoqërisë;
5. Administratoret mund te delegojnë përfaqësues te posaçëm për kryerjen e akteve te veçanta ose te një kategori aktesh, duke përcaktuar kompetencat përkatëse;
6. Te thërrasë Asamblenë e Ortakeve ne rastet e parashikuara me ligj;
7. Si dhe çdo te drejte tjeter e cila është përcaktuar me ligj për arritjen e qëllimit te shoqërisë

NENI 18 PERFAQESIMI I ADMINISTRATORIT

Administratori ka te drejtën e përfaqësimit te shoqërisë kundrejt te trentëve dhe ne gjykim. Ai mund te caktoje avokate dhe përfaqësues te shoqërisë përparrë organeve gjyqësore, organeve te administratës shtetërore dhe te trentëve, si dhe përfaqësues te posaçëm për akte te veçanta apo kategori aktesh. E drejta e firmës se shoqërisë mund te ushtrohet edhe nga personat te cilëve u është deleguar kjo e drejte brenda kufijve te kompetencave te dhëna.

Administratori ka te drejtën e reimbursimit te shpenzimeve te bëra gjate ushtrimit te funksioneve si dhe një shpërbirim vjetor te përcaktuar nga asambleja e ortakeve ne momentin e emërimit ose me vendim te posaçëm.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR

NENI 19 VITI FINANCIAR

Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqërisë nis me regjistrimin e saj ne organet tatimore, ndërsa për vitet ne vijim nga data 1 janar deri me 31 dhjetor te çdo viti.

Ne fund te çdo periudhe te ushtrimit te aktivitetit hartoher bilanci kontabël, brenda afateve dhe konform ligjeve ne fuqi.

Dokumentet e kontabilitetit, te shoqëruar nëse e nevojshme nga relaciioni i ekspertit kontabël te autorizuar, duhet t'u komunikohen ortakeve dhe te vihen ne dispozicionin e tyre pranë selisë se shoqërisë, te paktën 15 dite përparrë datës se mbledhjes se asamblesë.

Shoqëria ka llogarinë rrjedhëse te saj si dhe librat kontabël ne përputhje me kërkeshat e ligjit për kontabilitetin dhe dispozitave te tjera fiskale ne Republikën e Shqipërisë

Transferimi i vlerave monetare dhe transaksionet financiare do te kryhen ne baze te kritereve te përcaktuara nga Banka e Shqipërisë.

NENI 20 MARREDHENIET E PUNES



A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized 'J' or 'L' shape, is placed here. A small number '7' is written to the right of the signature.

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratave te punës dhe konform Kodit te Punës se Republikës se Shqipërisë.

**NENI 21
FITIMET**

Fitimet qe rezultojnë nga bilanci ushtrimor do te shpërndahen ndërmjet ortakeve pasi te jene zbritur nga kjo shume vlera e humbjeve te pësuara gjate vitit ushtrimor paraardhës si dhe 5% (pese për qind) qe destinohet për fondet e rezervës se domosdoshme, derisa kjo te ketë arritur kufirin e parashikuar me ligj.

Pjesa qe mbetet pas zbritjes se zërave te mësipërm, do tu shpërndahet pronareve te kuotave te kapitalit themeltar përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e tyre, ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, me përjashtim te destinimit te ndryshëm te vendosur nga vete ortaket.

**NENI 22
FINANCIMI I ORTAKEVE**

Shoqëria mund te marre nga ortaket financime me ose pa shpërblim, ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Dhënia e këtyre financimeve nga ana e ortakeve është e lire.

**NENI 23
MBYLLJA E AKTIVITETIT**

Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim te Asamblesë se Ortakeve te shoqërisë kur:

1. Veprimtaria e shoqërisë është negative;
2. Veprimtaria e shoqërisë është e pamundur;
3. Shpërndahet me vullnet te ortakeve;
4. Riorganizohet ne një forme tjetër;
5. Si dhe ne çdo rast tjetër te parashikuar nga ligji.

**NENI 24
LIKUIDIMI**

Kur verifikohet një nga shkaqet e parashikuara ne Nenin 23 te këtij Statuti, Asambleja e Ortakeve cakton një ose me shume likuidatorë te cilët do te kryejnë te gjitha veprimet e nevojshme përlukuidimin e saj, duke likuiduar ne radhë te pare detyrimet e shoqërisë ndaj shtetit e me pas ndaj te trentëve.

Ne rast se kapitali i shoqërisë do te jete i pamjaftueshëm, ortaket e shoqërisë janë detyrimin për te derdhur kuotat e tyre deri ne nivelin e pjesëmarrjes ne kapitalin fillestar.

**NENI 25
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHEVE**

Mosmarrëveshet qe mund te lindin ndërmjet ortakeve ose ndërmjet ortakeve dhe shoqërisë dhe qe ka lidhje me te drejta te disponoheshe ne lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane.

**NENI 26
LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM**

Çdo gjë qe nuk është parashikuar ne këtë statut do te disiplinohet nga dispozitat ligjore ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë.

NENI 27

DISPOZITA FINALE

Për te gjitha mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin e akteve dhe dokumenteve si me lart, versioni ne shqip do te jete ligjërisht detyrues.

Tirane me 22.02.2021

Ortaku i shoqerise “**FUGAZI**” sh.p.k

Z. Armir Sinani

Armir Sinani